

UDHËZIM
Nr.11/1, datë 31.10.2007

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN E PËRBASHKËT TË MINISTRIT TË BUJQËSISË,
USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT ME NR.4160, DATË 12.9.2006 DHE
MINISTRIT TË FINANCIVE ME NR.6829, DATË 13.9.2006 “PËR ZBATIMIN E
VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.555, DATË 16.8.2006 “PËR KTHIMIN E
FONDEVE FINANCIARE NGA SUBJEKTET QË PËRFITOJNË NGA PËRDORIMI I
FONDIT KUNDËRPARTI TË GRANTEVE JAPONEZE, PËR PROJEKTIN “RRITJA E
PRODHIMIT USHQIMOR 2KR”, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMET NR.479,
DATË 19.7.2001, NR.373, DATË 5.6.2003 DHE NR.114, DATË 25.2.2005 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE””**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.555, datë 16.8.2006 “Për kthimin e fondeve financiare nga subjektet që përfitojnë nga përdorimi i fondit kundërparti të granteve japoneze për projektin “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR”, dhe për një ndryshim në vendimet nr.479, datë 19.7.2001, nr.373, datë 5.6.2003 dhe nr.114, datë 25.2.2005 të Këshillit të Ministrave”, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministri i Financave

UDHËZOJNË:

- Në udhëzimin e përbashkët me nr.4160, datë 12.9.2006 të Ministrisë të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe nr.6829, datë 13.9.2006 të Ministrisë të Financave, bëhet ky ndryshim:

1. Pika 12 riformulohet:

“Për rastet e mospagimit në kohë të këstit, subjekti përfitues i mallrave, pajisjeve, linjave të agropërpunimit dhe serave me ngrohje, penalizohet me një kamatëvonesë 5% në vit të vlerës së këstit të papaguar, e llogaritur kjo për çdo ditë pune deri në ditën e kryerjes së pagesës.”

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT
DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
Jemin Gjana

MINISTRI I FINANCIVE
Ridvan Bode